



PLAN PENSIONAL
PËR SIGURIMIN PENSIONAL PLOTËSUES

 **FONDI**
Anëtar i Prva Group



PLANI PENSIONAL PËR SIGURIMIN PENSIONAL PLOTËSUES “FONDI VULLNETAR”

Provizione të Përgjithshme

Neni 1

Terme të caktuara që janë përdorur në këtë plan pensional, kanë këtë kuptim:

- Ligji** - Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës nr. 04/L-101.
- BQK** – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, organ/autoritet i cili rregullon dhe mbikëqyr institucionet financiare përfshirë edhe fondet plotësuese pensionale dhe menaxherët e aseteve.
- Ofruesi i planit pensional** - Është FONDI SLOVENO - KOSOVAR I PENSIONEVE SH.A, Rr. Ukshin Hoti Nr.45/10, Prishtinë
- Pensionimi plotësues (Suplementar)** - këtu e tutje përkufizohet si e drejta për të pranuar pagesë në formë të pagesave mujore pensionale, që fitohen nga personi i siguruar me sigurimin vullnetar pensional;
- I siguruari** – është personi i përfshirë në këtë plan pensional, dhe bazuar në këtë plan pensional, ka të drejtën në pensionim plotësues apo pensione tjera të ofruara nga ky plan pensional
- Periudha e kursimeve** – është periudha gjatë të cilës i siguruari vetvetiu (i punësuar apo i papunësuar), përkatësisht punëdhënësi në llogarinë e të siguruarit paguan kontributin për sigurimin vullnetar të pensionit plotësues;
- Fondi** – është pasuria e kontribuesve, e zbritur nga shpenzimet administrative të fondit vullnetar pensional, që investohet në bazë të ligjit për fonde pensionale dhe rregullave për investime të përcaktuara nga BQK-ja, ku rreziku për investime i përcillet të siguruarve
- Vlera blerëse** – është vlera e fondeve të grumbulluara të të siguruarit në llogarinë e tij personale, e rritur për fitimin nga investimet e këtyre fondeve të cilat u përkasin të siguruarve në kohën e përfundimit të sigurimit, apo që i përkasin individëve të akredituar (të njohur) të emëruar në kontratë nga i siguruari në rastet e anulimit të sigurimit para daljes në pension për arsye të vdekjes së të siguruarit
- Kontributi bruto** – kontributi i paguar në emër të personit të siguruar nga punëdhënësi i tij apo nga vet personi si pagesë individuale.
- Kontributi neto** – është kontributi bruto i zbritur nga tarifa hyrëse (tarifa administrative) e ngarkuar nga fondi pensional
- Kujdestari** – është një i besuar i cili është bankë e licencuar dhe entitet ligjor në Kosovë, apo degë e një banke të huaj e cila është entitet ligjor i licencuar nga BQK-ja për të bërë afarizëm në Kosovë, apo i licencuar për të bërë afarizëm në çfarëdo shteti anëtar të OBZHD-së apo BE-së nga autoriteti rregullator bankar i atij shteti, dhe i cili i ofron ofruesit të pensioneve shërbime të kujdestarisë dhe depozitave lidhur me asetet pensionale në bazë të marrëveshjes së kujdestarisë.

- Llogaria Individuale e fondit pensional** - nënkupton llogarinë e cila mirëmbahet nga fondi vullnetar pensional me qëllim të pasqyrimin të të gjitha kontributeve të bëra në emër të një pjesëmarrësi dhe të çfarëdo të ardhure, shpenzimi, përfitimi, dhe humbjeje të bëra në emër të pjesëmarrësit të tillë, apo të alokuara tek ai, me shpenzime më të vogla të lejuara. Kontributet në llogaritë individuale mund të bëhen nga punëdhënësi apo Individidi dhe duhet dhënë llogari ndarazi për to.

Forma e Fondit Pensional

Neni 2

Ky fond pensional do të organizohet sipas këtij plani pensional me sistem të skemës së kontributit të definuar të pensioneve.

Emri dhe Lokacioni i Fondit

Neni 3

Tipi i Fondit: FONDI VULLNETAR PENSIONAL

Lokacioni: Rr. Ukshin Hoti Nr.45/10, Prishtinë

Subjekti i Planit Pensional

Neni 4

- Ky plan pensional rregullon kushtet e sigurimit pensional plotësues, me të cilin i siguruari, qoftë kompani apo individ i përfshirë në këtë plan pensional, për kontributet e paguara fitojnë të drejtën për zbritje në tatimet personale për individë, si dhe për kompanitë që kyqen në plan pensional për llogaritja e primit të trajtohet si shpenzim.
- Sigurimi plotësues pensional me këto urdhëresa (këtu e tutje i referuar me emrin: plan pensional) mbulon pagesën e pensioneve plotësuese dhe pensioneve të tjera të përshkruara në këtë plan pensional.

Ofruesi i Planit Pensional

Neni 5

- Ofruesi i këtij plani pensional është Fondi Sloveno-Kosovar I Pensioneve sh.a. i cili do të:
 - grumbullojë kontributet e paguara në mënyrë vullnetare dhe do të hapë dhe mirëmbajë llogaritë personale për secilin të siguruar, qoftë individ apo kompani,
 - menaxhojë fondet / pasurinë e FONDI-t dhe të fondit pensional
 - përgatisë totalin e kursimeve të të siguruarit në llogarinë e tij personale, dhe pasi të jenë plotësuar kushtet për pension dhe në pajtim me ligjet në fuqi, i siguruari ka të drejtë të blejë kështet vjetore të pensionit dhe do të mund të zgjedhë nga opsionet që përcaktojnë mënyrën e tërheqjes së fondeve,
 - meqë fondi vullnetar pensional është gjithashtu i licencuar si ofrues i pensioneve, ajo do të paguajë pensionet kontribuesve të tyre të cilët i plotësojnë kushtet në pajtim me këtë plan pensional.
- Plani pensional është i dedikuar për sigurime vullnetare të pensionit plotësues.

Sigurimi pensional plotësues, siç përkufizohet në këtë plan pensional, paraqet grumbullimin e fondeve financiare në formë të kësteve nëpërmjet sigurimit vullnetar të pensioneve plotësuese në llogaritë personale të të siguruarve në fondin vullnetar pensional.

Qëllimi i grumbullimit (akumulimit) të fondeve është që të fitohet e drejta për pagesa të pensionit plotësues pasi që të jenë plotësuar kushtet e përcaktuara nga ky plan pensional

Sigurimi pensional plotësues vullnetar, bazuar në këtë plan, është një formë e sigurimit me të cilin i siguruari pranon rrezikun e investimeve të kontributeve të paguara.

Përfshirja në Planin Pensional

Neni 6

Plani pensional ofron mundësinë e përfshirjes së kompanive si punëdhënës, individëve si të punësuar apo vullnetarisht, dhe të banorëve të Kosovës të cilët kryesisht qëndrojnë jashtë vendit, të cilët vullnetarisht dhe me vullnet të lirë dëshirojnë të përfshihen.

1. Punëdhënësi

a) Kontributi paguhet vetëm nga ana e punëdhënësit (Iloji i kontratës: A)

Punëdhënësi dhe fondi vullnetar pensional nënshkruajnë kontratë hyrëse ku definohet shuma dhe frekuenca e pagesës (në baza mujore, tre-mujore, gjysmë-vjetore apo vjetore) së kontributeve që punëdhënësi do të paguajë për të punësuarit e vet. Të punësuarit marrin një vërtetim nga fondi pensional i sigurimeve vullnetare pensionale se janë hapur llogaritë individuale në emër të tyre. Kontributet paguhet nga punëdhënësi si një shumë e vetme. Punëdhënësi i dërgon fondit vullnetar pensional informatat e kërkuara në formën e specifikuar që fondi vullnetar pensional i dërgon punëdhënësit. Me kontratën hyrëse, i siguruari pranon se ai/ajo është njoftuar me këtë plan pensional.

b) Kontributi paguhet nga të dy, punëdhënësi dhe i punësuarit (Iloji i kontratës: B)

Punëdhënësi dhe fondi vullnetar pensional nënshkruajnë kontratë hyrëse ku specifikohet shuma e kontributit që punëdhënësi do të paguajë për të punësuarit. Të punësuarit po ashtu nënshkruajnë kontratë individuale me fondin vullnetar pensional, ku specifikohet vlera e kontributit që ata dëshirojnë të paguajnë dhe t'u zbritet nga paga e tyre bruto. Të punësuarit po ashtu marrin një vërtetim nga fondi vullnetar pensional, se janë hapur llogari individuale në emër të tyre. Punëdhënësi dhe të punësuarit zgjedhin formën e pagesës (mujore, tre-mujore, gjysmë-vjetore apo vjetore). Kontributet paguhet prej punëdhënësit si dy shuma të ndara (shuma e mbledhur e kontributeve të paguara nga Punëdhënësi, dhe shuma e kontributeve të paguara nga të Punësuarit). Punëdhënësi i dërgon informatat e kërkuara fondit vullnetar pensional në format e specifikuar që fondi vullnetar pensional i dërgon punëdhënësit. Me kontratën e hyrjes, i siguruari pranon se ai/ajo është njoftuar me këtë plan pensional.

c) Kontributi paguhet vetëm nga i Punësuarit (Iloji i kontratës: C)

Punëdhënësi dhe fondi vullnetar pensional nënshkruajnë kontratë hyrëse. Kontrata hyrëse përmban të gjitha informatat relevante për hapjen e llogarisë personale. Të punësuarit po ashtu nënshkruajnë kontrata individuale me fondin vullnetar pensional, ku specifikohet vlera e kontributeve që ata janë të gatshëm të paguajnë dhe t'u zbritet nga pagat e tyre bruto. Punëdhënësi zgjedh periudhën e pagesës (mujore, tre-mujore, gjysmë-vjetore apo vjetore). Bazuar në këto kontrata individuale, fondi vullnetar pensional hapë llogari individuale në fondin pensional për këta punëtorë. Kontributet paguhet si një shumë e vetme nga punëdhënësi. Punëdhënësi i dërgon fondit vullnetar pensional informatat e kërkuara në formën e specifikuar që fondi vullnetar pensional i dërgon punëdhënësit. Me kontratën hyrëse, i siguruari pranon se ai/ajo është njoftuar me këtë plan pensional.

Në rastet kur punëdhënësi nuk pranon të nënshkruaj kontratë hyrëse me FSKP-në, atëherë personi i siguruari i cili nënshkruan kontratë me FSKP-në

konsiderohet si individë.

2. Individët

Individët si të vetë-punësuar, të punësuar (shiqo llojin e kontratës: C) të papunësuar apo banorë të Kosovës që punojnë jashtë vendit nënshkruajnë kontratë me fondin vullnetar pensional dhe paguajnë kontributin vetëm personalisht bazuar në udhëzimet për pagesë që ipen nga fondi vullnetar pensional. Kontrata hyrëse do të përmbajë të gjitha informatat relevante për të hapur një llogari personale tek fondi vullnetar pensional. Me kontratën hyrëse, i siguruari pranon se ai/ajo është njoftuar me këtë plan pensional

Të gjitha të dhënat e anëtarit të siguruar do të mbrohen dhe do të trajtohen në mënyrë të besueshme si fshehtësi afariste nga ana e fondit vullnetar pensional.

Mosha minimale për përfshirje në planin pensional është mosha e lejuar për punë në pajtim me ligjet në fuqi. Ky kusht vlen për të gjitha kategoritë.

Neni 7

Në kontratën hyrëse, në formë të shkruar, i siguruari mund të emërojë një person (apo më shumë persona) i cili në rast të vdekjes së tij/saj, do të trashëgojë dhe me këtë do të pranojë pagesën e vlerës blerëse në llogarinë personale të tij/saj që ka me fondin vullnetar pensional. Çfarëdo ndryshime të mëvonshme, siç janë emërimi apo shfuqizimi i personit/ave të pranuar që do të trashëgojë vlerën blerëse - obligon fondin vullnetar pensional të ndryshojë trashëguesin vetëm atëherë kur ndryshimet e këtilla pranohen në formë të shkruar.

Neni 8

Anëtar i siguruar është zotëruar i një llogarie personale në fondin vullnetar pensional.

Fondi vullnetar pensional do të menaxhojë ndaras fondet në llogaritë individuale që vijnë nga kontributet e paguara pensionale, nga punëdhënësi dhe punëtori, ose nga individët e tjerë.

Vlerat e fondeve në llogaritë personale të të siguruarit llogariten një herë në muaj dhe kjo bëhet në fund të muajit të caktuar si shumë e kontributeve të pastra dhe fitimit nga investimet. Fitimet nga investimet në fondin vullnetar pensional publikohen në internet (në uebfaqen e fondit vullnetar pensional) njëherë në muaj, në fund të çdo muaji kalendarik. Ky regjistrim bëhet në momentin e shndërrimit të gjendjes së llogarisë individuale në atë të njesisë llogaritare.

Neni 9

Punëdhënësi i bashkohet këtij plani pensional duke:

- pranuar kushtet e sigurimit të pensionit plotësues, të përcaktuara nga ky plan pensional, si kushte të planit pensional që punëdhënësi do të financojë dhe
- për të siguruarit që do të përfshihen në mënyrë kolektive përmes punëdhënësit në këtë plan pensional, obligohet të paguajë në total apo pjesërisht kontributet për sigurimin pensional suplementar
- Punëdhënësi dhe fondi vullnetar i pensioneve nënshkruajnë një kontratë për të hyrë në planin pensional.

Kontrata në mes të fondit vullnetar pensional dhe punëdhënësit përmban këto elemente:

- Të dhënat për të dy palët kontraktuese
- Deklaratën që punëdhënësi pajtohet me kushtet e përfshirjes në planin pensional.
- Të dhënat për kontributet që punëdhënësi pranon të paguajë për të gjithë apo për një pjesë të punëtorëve

Bashkëngjitur me kontratën, punëdhënësi duhet të ofrojë listën e të punësuarve për të cilët paguhet kontributet. Punëdhënësi po ashtu obligohet të njoftojë zbatuesin e planit pensional për të gjitha

ndryshimet, për punësimet e reja në institutin e tij apo ndërmarrjen, si dhe për çdo punëtor që e lëshon punën për të cilin punëdhënësi paguan totalin apo një pjesë të kontributeve të tij të sigurimit.

Kontributet dhe modaliteti (mënyrat) i Pagesave të Kontributeve

Neni 10

Kontributi, bazuar në këtë plan pensional, është shuma e parave të paguara nga:

- I siguruari apo punëdhënësi I tij/saj (pjesërisht apo në total) në emër të të siguarit, me qëllim që në kohën kur i plotëson kushtet, I siguruari e fiton të drejtën për të zgjedhur një prej mundësive që ofrohen me këtë plan pensional. (përmendur në nenin 42)
- I siguruari që përfshihet në këtë plan individualisht

Neni 11

Niveli i kontributit fillestar vendoset nga i siguruari dhe fondi vullnetar pensional me kontratë, përkatësisht, mund të vendoset gjithashtu edhe me kontratë me punëdhënësin në rastet kur punëdhënësi paguan një pjesë apo totalin e kontributeve për të punësuarit e vet.

Niveli i kontributeve mund të vendoset qoftë si një shumë absolute ashtu edhe me përqindje nga paga bruto e të siguarit.

Kontributi minimal mujor në bazë të këtij plani pensional është:

1. Në rast të përfshirjes së të punësuarve, atëherë deri në 10% të pagës bruto nga punëdhënësi, dhe 10% nga paga bruto e të punësuarit dhe jo më pak se 10 Euro në muaj. (Kushti vlen nëse dy palët paguajnë maksimumin prej 10% secili, përndryshe mund të jetë më e ulët se ajo shumë)
2. Në rast të përfshirjes së të punësuarve apo banorëve të tjerë të Kosovës në mënyrë individuale dhe pa pjesëmarrjen e punëdhënësit, maksimumi prej 10% i pagës bruto sigurimin pensional plotësues apo jo më pak se 10 Euro

Ndryshimi (rritja ose zvogëlimi) i kontributit që paguhet nga punëdhënësi apo individët, po ashtu mund të bëhet në kohë të mëvonshme me një marrëveshje të shkruar me fondin vullnetar pensional.

Shuma e kontributeve që është vendosur të paguhet si shuma absolute, harmonizohet një herë në vit me rritjen e çmimeve me pakicë.

Neni 12

Kontributet duhet të paguhen në llogarinë bankare të fondit.

Kontributi llogaritet si i paguar në ditën kur pagesa mbërrin në llogarinë bankare të fondit.

Personi i siguarar përfiton në kontributin neto të paguar në muajin aktual prej ditës së parë të muajit vijues.

Neni 13

I siguruari, përkatësisht punëdhënësi vonohet me pagesën e kontributeve, nëse kontributi s'është paguar në shumën e vendosur apo në datën e përcaktuar me kontratë.

Punëdhënësi i cili përfshihet në planin pensional është i obliguar që kontributet totale apo të pjesëshme për punëtorët e tij t'i paguajë me kohë apo në intervalin kohor të përkufizuar në kontratë. Në rast të vonesës të pagesës së kontributeve, punëdhënësi obligohet t'i paguajë fondit vullnetar pensional kamatën për vonesën në pagesë në nivel prej

0.2 % në muaj. Kjo po ashtu aplikohet për kategorinë e individëve që janë të punësuar apo të vet-punësuar.

Individët të cilët nuk janë të punësuar apo që punojnë jashtë vendit si qytetarë të Kosovës nuk duhen të paguajnë kurrfarë kamate për vonesë në pagesën e kontributeve.

Vonesa në pagesën e kontributeve mund të jetë arsye për largim nga sigurimi pensional nga ana e fondit vullnetar pensional.

Kontributi Neto (I Pastër)

Neni 14

Kontributi neto (i pastër) sipas këtij plani pensional është kontributi i paguar, i zbritur nga shpenzimet administrative (këtu e tutje referuar si: tarifa hyrëse) që i përkasin fondit vullnetar pensional.

Kontributi neto i paguar do të llogaritet në numrin adekuat të njësive llogaritëse të FONDIT VULLNETAR. Llogaritja do të bëhet në ditën e shndërrimit (konvertimit) në pajtim me vlerën e njësisë (këtu e tutje referuar si: VN) në atë ditë.

Njësitë llogaritëse, të llogaritura për secilin individ të siguarar, i atribuohen llogarisë së tij/saj personale.

Politika e Investimit

Neni 15

Për përmbushjen e obligimeve nga sigurimi pensional plotësues në bazë të këtij plani pensional, në periudhën e kursimeve fondi vullnetar pensional do të formojë një fond pensional.

Fondi vullnetar pensional do të pranojë mjete monetare nga mjetet mbuluese të Fondit për përmbushjen e obligimeve kontraktuese ndaj personave të siguarar në bazë të këtij plani pensional.

Në planin pensional, fondi vullnetar pensional, në periudhën e kursimeve do të grumbullojë mjete financiare nga kontributet e paguara neto dhe do t'i investojë dhe menaxhojë ato në bazë të politikave investuese që bazohet në Rregullin 9 të lëshuar nga BQK-ja dhe të përkufizuar me këtë plan pensional.

Fondi vullnetar pensional do t'i ndajë mjetet e fondit pensional nga mjetet e veta, dhe do t'i menaxhojë ndaras.

Neni 16

Për periudhën e kursimeve, fondi vullnetar pensional do t'i investojë mjetet e fondit pensional në të gjitha llojet e lejuara të investimeve, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi dhe do t'i shfrytëzojë këto kushte specifike:

- a) Rregullat e shpërndarjes. – Në çdo kohë, investimet e fondit pensional janë subjekt i kushteve specifike si më poshtë:
 - i. Aksionet apo aksionet e kapitalit nuk mund të jenë më të larta se 5 % e totalit të aksioneve të lëshuara nga një lëshues.
 - ii. Obligacionet nuk mund të jenë më të larta se 30 % të një emetimi të vetëm të obligacionit.
 - iii. Investimi total në secilin entitet, duke përfshirë edhe entitetet e përbashkëta të tij, nuk mund të jetë më i lartë se 5 % e pensionit total.
- b) Kërkesa për vlerësim. – Për mbrojtje të vazhdueshme të cilësisë së fondeve pensionale, BQK-ja kohë pas kohe mund të përshkruajë nivelin minimal të investimeve apo klasifikimin e fondeve për të

përcaktuar pranueshmërinë e investimit. Niveli i investimeve apo kushtet e klasifikimit duhet të krijojnë një pjesë apo një pako të kësaj Rregulloreje në datën e rregulluar nga urdhëresat me shkrim të BQK-së të cilat përshkruajnë atë lloj të kërkesës(ave).

Investimet do të zgjidhen nga fondi vullnetar pensional në atë mënyrë që siguria do të garantohet, fitimi dhe tregtia me investime në periudha të caktuara, lloji dhe sektori i këtyre investimeve.

Investimet në fondet e lejuara në Kosovë apo të lokalizuara jashtë Kosovës

Asetet (pasuria) e pensioneve mund të investohet vetëm në llojet dhe në klasat ndërkombëtare si më poshtë:

- Fondet Monetare – duke përfshirë llogaritë bankare dhe depozitat bankare në bankat që janë të licencuar nga Autoriteti Rregullator Bankar i shteteve anëtare të OBZHD-së, dhe licenca e të cilave është ende e vlefshme dhe në gjendje të mirë.
- Fondet e lëshuara nga cilido shtet anëtar i OBZHD-së.
- Fondet e lëshuara nga qeveritë lokale të shteteve anëtare të OBZHD-së deri në masën e garantuar nga shteti përkatës.
- Fondet e regjistruara nga Rregullatori i tregut të kapitalit në cilindo shtet anëtar të OBZHD-së, të vëna në ofertë publike dhe të regjistruara në mënyrë aktive apo të shitur në Bursën e Aksioneve në atë shtet (ato shtete) ku kjo është e rregulluar dhe e monitoruar në mënyrë përkatëse.
- Fondet e ndërsjella dhe fondet e tjera investuese (Entitetet e hapura “open-end”) të cilat i nënshtrohen aprovimit nga shtetet anëtare të OBZHD-së lidhur me themelimin e tyre, dhe për të cilat janë përshkruar kriteret e përshtatshmërisë nga ana e autoritetit përkatës rregullator dhe mbikëqyrës në ato shtete, lidhur me zhvillimin e aktiviteteve afariste të entiteteve të tilla të hapura (“open-end”).
- Të gjitha llojet dhe klasat e tjera të fondeve ndërkombëtare siç mund të autorizohen kohë pas kohe, nga ligjet në fuqi, statuti, rregulloret dhe rregullat e lëshuara nga autoriteti kompetent në Kosovë.

Investimet në Fondet e lejuara në Kosovë apo të lokalizuara brenda Kosovës

- Fondet monetare, duke përfshirë llogaritë bankare dhe depozitat bankare që janë të licencuara nga BQK-ja që e zhvillon biznesin bankar në Kosovë në raport të mirë me kërkesat rregulluese të BQK-së.
- Fondet e lëshuara nga autoriteti kompetent në Kosovë, në masën e garantuar nga autoriteti i tillë.
- Fondet e lëshuara nga ndërmarrjet publike dhe / ose private që janë të regjistruara në rregullatorët e tregut kapital në Kosovë, marrë parasysh që këto fonde janë të regjistruara dhe tregtohen në tregun(tregjet) e fondeve të licencuara në Kosovë apo në shtetet anëtare të OBZHD-së, dhe i nënshtrohen rregullimit dhe mbikëqyrjes nga autoriteti i aplikueshëm i tregut kapital në shtetin e tillë.
- Fondet e ndërsjella dhe fondet e tjera të investimit (entitetet e hapura “open-end”) të cilat i nënshtrohen aprovimit në Kosovë, dhe për të cilat janë përshkruar kriteret e përshtatshmërisë nga autoriteti adekuat rregullator apo mbikëqyrës në Kosovë lidhur me zhvillimin e aktivitetit afarist të entitetit të tillë të hapur “open-end”.
- Të gjitha llojet dhe klasat e tjera të fondeve vendore që mund të autorizohen kohë pas kohe nga ligjet në fuqi, statutet, rregulloret dhe rregullat e lëshuara nga autoriteti kompetent në Kosovë.

Investimet e Ndaluar

Pasuria (asetet) e pensioneve nuk mund të investohet në llojet apo klasat e investimeve në vijim:

- Fondet që nuk janë të listuara (regjistruara) apo që nuk tregtohen publikisht. Pasuria e cila ligjërisht nuk mund të bartet, të shitet, të largohet apo të tjetërsohet.
- Fondet derivative, opsionet, kontratat e ardhme (‘futures’), të përparshmet dhe marrëveshjet e tjera në lidhje me fondet dhe pasuritë e tjera financiare.
- Asetet e vërteta apo materiale jo të listuara në tregjet e organizuara dhe për të cilat vlerësimi është i pacaktuar, duke përfshirë por jo duke u kufizuar vetëm në objektet me vlerë, veprat artistike, antikitetet, monedhat, koleksionet dhe vetura motorike.
- Fondet e lëshuara nga palët e përshkruara siç përkufizohet në këtë Rregull.
- Fondet të cilat nuk i takojnë llojit dhe klasës së lejuar brenda Rregullores së Pensioneve apo këtij Rregulli, dhe/apo fondet e siguruar që nuk janë në pajtueshmëri me parimet e investimeve dhe direktivat e entitetit të pensioneve në kohën e përvetësimit të tyre.
- Pasuria dhe fondet e tjera të tilla siç specifikohen nga ligjet, statuti, rregulloret dhe rregullat e lëshuara nga autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës.

Parimet e investimeve të deklaruara më lartë janë në pajtueshmëri me politikën investuese të fondit vullnetar pensional.

Neni 17

Fondi vullnetar pensional mund të transferojë në total apo pjesërisht asetet (pasurinë) e fondit pensional tek një institucion tjetër i cili përmbush kushtet ligjore për menaxhim të aseteve, siç përcaktohet në ligj.

Shpenzimet e llogaritura nga fondi vullnetar pensional

Tarifa Hyrëse

Neni 18

Në çdo pagesë të kontributit, fondi vullnetar pensional llogaritë tarifën hyrëse që i përket fondit vullnetar pensional. Niveli i tarifës hyrëse është deri në 3% të kontributeve të paguara.

Tarifa e Menaxhimit

Fondi vullnetar pensional ka të drejtë në 0,125% komisioni mujor për menaxhim të aseteve (këtu e tutje referuar si: tarifa e menaxhimit). Tarifa e menaxhimit llogaritet nga fondi vullnetar pensional në baza mujore, dhe paguhet me datën 10-të të muajit – për muajin paraprak.

Në rast se fondi qëndron më mirë se sa pika referuese e krahasimit e përcaktuar në nenin e brendshëm, atëherë menaxheri i Aseteve ka të drejtë në shpërbllim prej deri më 20% të prodhimit i cili ndodhet mbi pikën krahasuese.

Tarifa e Daljes

Në ndërprerjen e sigurimit pensional bazuar në këtë plan pensional, fondi vullnetar pensional ka të drejtën e tarifës dalëse prej:

- Gjer më 2%, për 10 vitet e para të sigurimit,
- Gjer më 1%, nëse sigurimi është më i gjatë se 10 vite,
- Gjer më 1%, në rast të vdekjes, nga vlera blerëse.

Neni 19

Në lidhje me administrimin e mjeteve të fondit pensional, fondi vullnetar pensional mund të realizojë llojet e shpenzimeve në vijim të cilat kanë ngjarë gjatë menaxhimit të fondit.

Shpenzimet për administrim, shpenzimet për investime, si më poshtë:

- Shpenzimet e pagesave për transaksionin e pagesave,
- Shpenzimet e intervenimit për shitjen dhe blerjen e fondeve (garancive),
- Shpenzimet për shërbimet e kryera nga Kujdestari I Fondeve,
- Shpenzimet e institucionit(eve) tjetër tek i cili është transferuar një pjesë apo totali i aseteve.
- Shpenzimet e Institucioneve mbikëqyrëse.
- Shpenzimet e shërbimit auditor të fondit pensional
- Shpenzimet e njoftimit të anëtarëve të fondit
- Shpenzimet që janë në lidhje me disponueshmërinë e garancive në pronësi të fondit dhe administrimit të llogarive për garancitë e fondit të cilat janë të pa-materializuara
- Shpenzimet që janë në lidhje me procedurat ligjore me organet e tjera qeveritare.

Vlera Neto e mjeteve të fondit

Neni 20

Vlera neto e mjeteve të fondit është vlera e mjeteve të fondit pasi janë zbritur shpenzimet administrative dhe shpenzimet e investimeve.

Fondi vullnetar pensional do të llogarisë vlerën neto të mjeteve të fondit. Llogaritja do të kryhet në ditën e fundit të muajit të caktuar, bazuar në vlerën e mjeteve dhe obligimeve në atë ditë.

Neni 21

VN-ja do të përcaktohet në ditën e konvertimit dhe ajo do të jetë barazi me vlerën neto të aseteve (VNA) në ditën e konvertimit, pjesëtuar me numrin e njësive të aseteve të FONDIT VULLNETAR në qarkullim në ditën e konvertimit:

$$VN = VNA / n$$

VNA = vlera neto e aseteve të FONDIT VULLNETAR në ditën e konvertimit

n = numri i njësive të aseteve në qarkullim në ditën e konvertimit

Numri i njësive llogaritëse në qarkullim në ditën e konvertimit do të jetë barazi me numrin e njësive në qarkullim një ditë para konvertimit dhe me numrin e njësive të konvertuara në ditën e konvertimit, minus numrin e njësive llogaritëse të blera në atë ditë. Numri i njësive të aseteve të përfituara në bazë të kontributit të paguar, nga individit anëtar i fondit, do të jetë i barabartë me kontributin neto të paguar të individit anëtar, pjesëtuar me VN-në në ditën e konvertimit.

Pjesëmarrja e të siguarit në fitimin e realizuar

Neni 22

100% e fitimit i takon të siguarit.

Fitimi i krijuar është ndryshimi në mes të vlerës neto të mjeteve të fondit dhe kontributeve neto të paguara në ditën e fundit të periudhës së llogaritjes.

Për të regjistruar një vlerë në llogarinë personale dhe në nën-llogari të fondit, fondi vullnetar pensional shfrytëzon njësitë e llogaritjes. Konvertimi i mjeteve të të siguarit nga kontributet në njësitë llogaritëse

bëhet nga fondi vullnetar pensional një herë në muaj.

Në fitimin e krijuar është përcaktuar se një pjesë proporcionale i takon secilit të siguar. Kjo pjesë është e dedikuar për krijimin e fitimit që i takon të siguarve.

Ndërprerja e Sigurimit – mënyrat e ndërprerjes

Neni 23

Sigurimi pensional plotësues vullnetar mund të ndërpritet në mënyrë të:

Rregullt:

- Kur anëtar i fiton të drejtën e pensionit plotësues të pleqërisë apo të drejtën e pensionit plotësues të hershëm të pleqërisë

Jashtëzakonshme:

- me largim (tërheqje),
- me anulim të kontratës mbi sigurimin pensional plotësues vullnetar nga fondi vullnetar pensional,
- me rastin e vdekjes së të siguarit/anëtarit para se të ketë gëzuar të drejtën për dalje në pension plotësues të pleqërisë me anë të kësteve mujore të pensionit.
- me rastin e ndërprerjes së operimit të fondit

Kushtet për të fituar të drejtën për pensionim pleqërie plotësues apo llojeve të tjera të përfitimeve të ofruara nga ky plan pensional

Neni 24

I siguruari e fiton të drejtën për pensionim pleqërie plotësues në bazë të këtij plani pensional, në datën kur plotësohen të dy nga këto kushte:

1. kur i siguruari arrin moshën 65 vjeçare,
2. me sukses e fiton të drejtën për pension bazuar në rregullat për pension themelor, siç ceket në Ligjin për Fondet Pensionale

Neni 25

I siguruari gëzon të drejtën për pension plotësues të hershëm, në datën kur plotësohen të dy kushtet në vijim:

1. i siguruari nuk ka mbushur 65 vjet, dhe
2. me sukses fiton të drejtën për pension bazuar në rregullat për pension invalidor siç definohet në ligjet e Kosovës.

Neni 26

I siguruari gëzon të drejtën për pagesë të pensionit plotësues apo pensionit plotësues të hershëm bazuar në aplikacionin me shkrim që i parashtrahet fondit vullnetar pensional së bashku me:

- kontratën ose dokumentin verifikues,
- dëshmia e të drejtës për pensioni themelor apo pension invalidor
- dëshmia për datën e tij të lindjes.

Fondi vullnetar pensional ka të drejtë, që të kërkojë nga i siguruari dëshmi të tjera të mundshme për përmbylljen e kushteve për fitimin e të drejtës për t'iu paguar pensioni plotësues, apo pensionit plotësues të hershëm.

Neni 27

Kur i siguruari fiton të drejtën për pension pleqërie plotësues apo pension pleqërie plotësues të hershëm, ai/ajo fiton të drejtën për vlerën blerëse. Fondi vullnetar pensional mund të përmbyll pagesë vjetore për të siguarin. I siguruari nënshkruan kontratë të re me Fondin ku ai/ajo specifikon llojin e kështit të pagesës së pensionit që dëshiron të pranojë.

Në ditën e fundit të muajit, pasi që i tërë dokumentacioni të jetë pranuar, fondi vullnetar pensional përcakton vlerën blerëse të aseteve. Më së largu në fund të muajit tjetër, kjo shumë pastaj transferohet dhe përdoret për blerje të pagesës vjetore të përzgjedhur.

Suspendimi (Pezullimi) i Përkohshëm i Pagesës së Kontributeve

Neni 28

Çdo i siguruar, në bazë të këtij plani pensional mund të pezullojë pagesën e kontributeve.

Pezullimi i tillë do të jetë i mundshëm, si në vijim:

- nëse sigurimi vullnetar pensional plotësues përfundon si rezultat i tërheqjes apo anulimit;
- nëse premia (kontributi) është paguar për periudhën prej së paku tre vitesh dhe me anë të aranzhimit të shkruar mes Anëtarit të siguruar dhe fondi vullnetar pensional;

Pezullimi do të zgjasë gjer në ri-vazhdimin e pagesës së kontributeve apo gjer në rastin e tërheqjes. Në asnjë prej rasteve të mësipërme nuk do të ngarkohen tarifa shtesë.

Brenda periudhës së pezullimit të pagesave, kamatat për vonesën për kontributet e papaguara nuk do të llogariten. Punëdhënësi apo i siguruari më vonë mund të vendosin të paguajnë kontributet e papaguara gjatë periudhës së pezullimit.

Neni 29

Shkarkimi (përrjashtimi) i të Siguarit nga Sigurimi, nga ana e fondit vullnetar pensional

Fondi vullnetar pensional posedon të drejtën që të anulohet sigurimin vullnetar të pensionit plotësues, në rast se:

- nuk janë paguar kontributet e sigurimit vullnetar të pensionit plotësues për 12 muaj me radhë, përveç në rast të suspendimit;
- anëtar i ka dhënë informacion apo fakte jo të mirëfillta të cilat kanë pasur ndikim në sigurimin gjatë përfshirjes apo pajtueshmërisë me planin pensional;

Njoftimi me shkrim hyn në fuqi në afat prej 30 ditëve, pasi t'i jetë dërguar të siguarit. Pas kalimit të këtij afati, sigurimi vullnetar pensional plotësues i të siguarit do të anulohet.

Vazhdimi i sigurimit pensional

Neni 30

Në qoftë se anëtar i sigurimit vullnetar plotësues ka përfunduar marrëdhënien e tij të punës me punëdhënësin i cili ka qenë duke financuar skemën pensionale, i siguruari ka të drejtën që të mbetet individualisht në planin pensional.

I siguruari që ka hyrë në planin pensional në mënyrë kolektive (në grup) përmes punëdhënësit të tij dhe punësimi i të cilit ka përfunduar, ka të drejtë të mbetet në planin pensional individualisht, nëse deklaron që dëshiron të vazhdojë sigurimin pensional suplementar bazuar në këtë plan pensional dhe të obligohet për pagesën e kontributeve, të cilat deri tash kanë qenë të paguara nga punëdhënësi.

Në rastet kur punëtori e ndërron vendin e punës, ai duhet t'i dërgojë një kërkesë fondi vullnetar pensional për vazhdimin e pagesës së kontributeve nga punëdhënësi i ri. Në rastet kur punëdhënësi i ri nuk ka kontratë me fondin vullnetar pensional kjo mund të zgjidhet në dy mënyra:

- punëdhënësi i ri nënshkruan kontratë me fondin vullnetar pensional dhe paguan për të gjithë punëtorët e tij
- i punësuar individualisht fillon të bëjë pagesat mujore të kontributeve
- në rastet kur i punësuar mbetet pa punë, ai ka të drejtë të shfrytëzojë periudhat e pushimit për pagesa për periudhë të pakufizuar të kohës deri kur ai/ajo punësohet përsëri dhe me këtë të jetë i detyruar të njoftojë fondin për punësimin e ri dhe të rifillojë pagesën e kontributeve

Para se të refuzohet i siguruari, fondi vullnetar pensional është i obliguar të informojë me shkrim të siguarin për refuzimin, dhe që ai ka të drejtën nga paragrafi i parë i këtij artikulli, që në një afat kohor prej 15 ditësh pas pranimit të informacionit, të deklarojë personalisht nëse do të shfrytëzojë këtë të drejtë. Informacionit duhet t'i bashkëngjitet forma e deklaramit për shfrytëzimin e kësaj të drejte.

Vdekja e të Siguarit

Neni 31

Në rastet kur i siguruari vdesë para se të përfitojë të drejtën në pension plotësues të pleqërisë në formë të pagesës mujore, sigurimi pensional do të anulohet në ditën e fundit të muajit në të cilin ka vdekur.

Përfituesi (nëse është cekur kështu nga anëtar i në deklaratën e anëtarësisë) do të përfitojë të drejtën e pagesës së vlerës së dorëzimit; nëse nuk është emëruar përfituesi, trashëguesit do të përfitojnë të drejtën në pajtim me ligjin mbi trashëgiminë.

Të drejtën nga paragrafi më lartë do ta shfrytëzojnë përfituesi apo trashëguesi nëpërmjet aplikimit me shkrim tek fondi, të cilit ata do t'i bashkëngjisin:

- kontratën apo dokumentin vërtetues të sigurimit pensional,
- certifikatën e vdekjes së të siguarit,
- identiteti personal i përfituesve apo trashëguesve,
- numri i xhirlogarisë bankare dhe numri i tatimit,
- vendimi i gjyqit mbi trashëgiminë, në rast se trashëguesit aplikojnë për vlerën e dorëzimit

Para pagesës së vlerës blerëse, fondi vullnetar pensional mund të kërkojë dëshmi të tjera, të cilat do të jenë të nevojshme për verifikim të identitetit të përfituesit apo trashëguesit.

Neni 32

Në ditën e fundit të muajit, kur të jetë pranuar dokumentacioni i plotë, fondi vullnetar pensional do të përcaktojë vlerën blerëse të aseteve. Kjo shumë paguhet më së largu në përfundimin e muajit të ardhshëm, si shumë e tërë apo transferohet tek llogaria individuale e përfituesit apo trashëguesit. Përfituesi apo trashëguesi mund të zgjedhin që të blejnë kështet pensionale me vlerën e blerjes.

Fondi vullnetar pensional mund të kërkojë reklamim (rikthim) të çfarëdo shume e cila i është atribuar gabimisht Përfituesit apo Trashëguesve.

Kalimi (Transferimi) në një Plan tjetër Pensional

Neni 33

I siguruari mund të transferohet tek një plan tjetër pensional pasi t'i ketë prezantuar fondin vullnetar pensional një deklaratë të shkruar për largim. Kjo duhet të përfshijë të gjitha detajet mbi fizibilitetin (realizueshmërinë) e planit pensional në të cilin kalon i siguruari.

Në deklaratën e formës me shkrim të fondit vullnetar pensional, i

siguruarit duhet të vendosë me saktësi nëse dëshiron që së bashku me kalimin të bëjë transferimin edhe të fondeve të grumbulluara në llogarinë personale. Nëse ai/ajo vendosë për transferimin e fondeve, në deklaratën e tij ai duhet të bashkëngjisë pranimin e fizibilitetit (realizueshmërisë) së planit pensional në të cilin ai kalon.

Në rast se fondi vullnetar pensional ka pranuar deklaratën e plotë të kalimit deri në ditën e fundit të muajit, afati i kalimit fillon në ditën e parë të muajit vijues. Afati i kalimit mbaron në ditën e fundit të muajit në të cilin ka filluar afati i kalimit.

Neni 34

Sigurimi në bazë të këtij plani pensional ndërpritet për arsye të kalimit në një plan tjetër pensional në ditën kur mbaron afati i kalimit.

Dita e llogaritjes së vlerës blerëse është dita e ndërprerjes së sigurimit. Fondi vullnetar pensional paguan fondet në shumën e vlerës blerëse në llogarinë e fondit pensional në të cilin kalon i siguruarit, deri në ditën e fundit të muajit vijues pas llogaritjes së vlerës blerëse.

Fondi vullnetar pensional ngarkon nga shuma e mjeteve në llogarinë individuale që do të transferohet, si në vijim:

- nëse janë paguar më shumë se 120 kontribute mujore deri në 180 kontribute mujore, tarifa dalëse është 2% e vlerës blerëse.
- nëse janë paguar më shumë se 180 kontribute mujore, tarifa dalëse është 1% e vlerës blerëse

Metoda e Llogaritjes së Vlerës Blerëse

Neni 35

Vlera blerëse është e barabartë me nivelin e fondeve të regjistruara në llogarinë personale të të siguruarit në ditën e fundit të muajit, para muajit në të cilin skadon sigurimi i të siguruarit në këtë plan. Vlera blerëse është e barabartë me numrin e njësive llogaritëse e shumëzuar me vlerën e njësive llogaritëse në atë ditë, të zvogëluar për tarifën dalëse.

Fondi vullnetar pensional, para se të paguajë vlerën blerëse, do t'i paguajë taksat e mundshme, nëse kjo i imponohet nga legjislacioni në fuqi.

Metoda e Llogaritjes dhe Llojet e Pensionit

Neni 36

Fondi vullnetar pensional është i licencuar për të bërë pagesën e pensioneve suplementare. Në vijim paraqitet përshkrimi i mënyrës së kalkulimit dhe llojeve të pensioneve që mund të zgjidhen nga i siguruarit pasi që ai/ajo të arrijë moshën 65 vjeçare apo në bazë të ligjeve në fuqi për pensionim. Ky plan pensional ofron këto lloje të pensioneve:

- a) pensioni i një-hershëm i pagueshëm gjer në vdekjen e pjesëmarrësit, në pajtim me tabelat e vdeksshmërisë që përdoren nga ana e fondit vullnetar pensional

Në këtë rast, përfituesi i pensionit përfiton pension me pagesë mujore derisa të jetë gjallë, e nëse personi vdes para kohës së parashikuar me tabelat e mortalitetit, atëherë pjesa e mbetur e fondeve në llogari do të mbetet në fondin special për mbulesë të fondit vullnetar pensional.

- b) Pensioni i pagueshëm për jetën e të Siguarit dhe pastaj bashkëshortit/es për pjesën e mbetur të jetës së tij apo saj

Në këtë rast, i siguruarit përfiton pension deri në fund të jetës së tij dhe vazhdon të përfitojë gruaja/burri që është gjallë deri në vdekjen e tij/saj. Edhe këtu si bazë për llogaritje merren tabelat e mortalitetit që shfrytëzohen nga Fondi vullnetar pensional.

- c) Pensioni i garantuar për periudhë prej së paku një (1) viti

Ky lloj i pensionit është afat-gjatë në një periudhë kohore prej 1 deri në 20 vjet nga fillimi i pensionit. Në rast të vdekjes së të siguruarit brenda afatit, të përcaktuar me kontratë, fondet e mbetura deri në fund të afatit të përcaktuar do të përfitohen nga përfituesi apo trashëgimtari/ët.

Nëse vlera e aseteve në llogarinë individuale pensionale në fillim të periudhës së anuitetit me rastin e daljes në pension është më e lartë se sa niveli i lejueshëm për t'u tërhequr menjëherë në shumë totale, Fondi vullnetar pensional mund të propozojë pagesat fazore nën këto kushte:

- Niveli i garantuar i interesit vjetor është minimum 1%
- Kosto administrative prej 0 deri 2%
- Pagesa për anuitet nuk mund të jetë më e vogël se EUR 500

I siguruarit mund të tërheqë shumën totale të aseteve individuale të grumbulluara në fillim të daljes në pension në rast se vlera e tyre është më e vogël se sa vlera e paraparë me rregullat pensionale në fuqi.

Neni 36 a)

Shpenzimet e FOND-it për pagesën e Pensioneve Kompania nuk ngarkon ndonjë tarifë për pagesën e pensioneve. Kompania duhet siguruar që ka asetet (mjete) të mjaftueshme për të mbuluar asetet e anëtarëve të Fondit2 (detyrimet ndaj anëtarëve të Fondit2) që do të thotë se ajo e bart rrezikun për të mbuluar diferencat negative në mes të aseteve të Fondit2 dhe aseteve të anëtarëve. Si rrjedhojë e këtij risku, Kompania ka të drejtë në tepricat e aseteve të Fondit2 që i tejkalojnë asetet e anëtarëve të Fondit2.

Neni 37

Niveli i shumës së pensionit plotësues varet nga:

- vlera blerëse e të siguruarit në momentin e gëzimit të të drejtave dhe
- arritja e moshës 65 vjeçare të të siguruarit me rastin e gëzimit të të drejtave

Neni 38

Dita e llogaritjes së vlerës blerëse e cila është baza e llogaritjes së kështit të pensionit mujor është dita e fundit e muajit, në të cilin fillon efektshmëria e deklaratës për gëzimin e të drejtës për sigurim të pensionit plotësues.

I siguruarit, duke gëzuar të drejtën për pension plotësues e zgjedh një prej mundësive të pagesës së kështit pensional të ofruar nga fondi vullnetar pensional.

Kujdestari i Fondit Pensional

Neni 39

Fondi vullnetar pensional ka nënshkruar marrëveshje me kujdestarin e mjeteve të fondit në pajtim me ligjet dhe rregulloret e BQK-së dhe ajo do ta publikojë emrin dhe adresën në uebfaqe. Kujdestari është pajtuar të pranojë të gjitha obligimet ligjore për të kryer detyrat e veta në pajtim me kërkesat e dhëna në Rregullin e botuar Nr:8 të BQK-së mbi kujdestarët e mjeteve pensionale.

Neni 40

Fondi vullnetar pensional mban të drejtën e kthimit të vlerës blerëse në rast se ajo është paguar pa arsye apo në saje të dokumentacionit të falsifikuar (mashtues).

Dispozitat Përfundimtare

Neni 41

Fondi vullnetar pensional për çdo vit do t'i informojë të siguruarit të cilët

janë pjesëmarrës sigurimin pensional suplementar për gjendjen e llogarive të tyre personale me datë 31/12 të vitit të fundit kalendarik. Fondi vullnetar pensional për çdo vit, gjatë tërë periudhës së sigurimit, do të informojë të siguarit mbi sigurimin e tyre të pensionit plotësues lidhur me statusin e llogarive të tyre personale më datën 31/12 të vitit të fundit kalendarik.

Informacionin nga paragrafi i mësipërm i këtij neni, fondi vullnetar pensional do t'ia prezantojë të siguarit më së voni më datë 30.06 të vitit – për vitin paraprak.

Neni 42

I siguari është i obliguar të informojë fondin vullnetar pensional për të gjitha ndryshimet të cilat mund të ndikojnë në sigurimin pensional plotësues, brenda një afati kohor prej 15 ditësh nga data kur fillojnë ndryshimet. I siguari është posaçërisht i obliguar të informojë fondin vullnetar pensional për ndryshimet në adresën e banimit dhe detajet e tjera të rëndësishme për dërgesa të rregullta postare.

Nëse i siguari nuk ka informuar fondin vullnetar pensional lidhur me ndërrim të adresës, është e mjaftueshme që fondi vullnetar pensional të informojë të siguarin përmes postës tek adresa e fundit postare që është shënuar.

Për shërbimet të cilat fondi vullnetar pensional do t'i kryejë për të siguarit, p.sh. dërgesat postare të informacioneve që nuk gjenden në këtë plan pensional, informata me kërkesë të të siguarit, dërgesa postare të kopjeve të dokumenteve, fondi vullnetar pensional mund të kërkojë pagesë shtesë, sipas çmimoreve të saj.

Neni 43

Struktura ligjore e marrëdhënieve ligjore në mes të të siguarit dhe fondit vullnetar pensional klasifikohet në bazë të kontratës për sigurimin pensional plotësues. Pjesët formuese të kontratës për sigurim pensional plotësues janë: kontrata hyrëse e të siguarit, kontrata për hyrjen e punëdhënësit në këtë plan pensional, plani pensional dhe marrëveshjet e tjera eventuale në mes të të siguarit dhe fondit vullnetar pensional.

Struktura ligjore e marrëdhënieve ligjore në mes të punëdhënësit, të siguarit, të cilët kanë hyrë kolektivisht (si grup) në këtë plan pensional dhe fondit vullnetar pensional, klasifikohet po ashtu sipas hyrjes në planin pensional.

Të gjitha kërkesat dhe deklaratat të cilat punëdhënësi, i siguari ose fondit vullnetar pensional i prezantojnë njëri-tjetrit, duhet të bëhen në formë të shkruar. Mjafton që të gjitha të prezantohen në ditën e njëjtë kur pranohen nga punëdhënësi apo i siguari

Neni 44

Nëse do të ketë ndryshime në legjislacionin i cili e rregullon sigurimin pensional plotësues apo në legjislacionin e taksave, do të shfrytëzohen drejtpërdrejt dispozitat ligjore, të cilat mund të ndërhyjnë në strukturën e këtij plani pensional.

Ndryshimet në këtë plan pensional aprovohen dhe hyjnë në fuqi me procedurën e njëjtë të planit përkatës, kurse do të shfrytëzohen në ditën kur ato aprovohen nga organet kompetent

Tatimet

Neni 45

Kontributet maksimale të cilat mund të ulen/zbriten prej tatimeve:

- Kontributi maksimal i cili zbritet nga taksat e kursimeve në sigurimin

pensional plotësues, për të punësuarit është 20% e pagës bruto (10 % ndahet nga punëdhënësi, 10 % nga i punësuar). Për punëdhënësin këto kontribute pranohen si shpenzime dhe e zbresin fitimin para tatimit, kurse për të punësuarin këto kontribute zbriten nga paga bruto para llogaritjes së tatimit personal në pagën bruto.

- Për individët të cilët janë të papunësuar dhe për ata të cilët janë banorë të Kosovës por të cilët nuk jetojnë në Kosovë, nuk ka kufizime për lartësinë e kontributeve sepse nuk janë të obliguar të paguajnë tatim në të ardhura (paga).

Fondi vullnetar pensional do t'i informojë të gjithë pjesëmarrësit e këtij plani pensional për mënyrën e llogaritjes dhe zbritjes së kontributeve nga të gjitha llojet e të ardhurave, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi të Kosovës të cilat përfshijnë taksat dhe llogaritjen e tyre.

Njoftimi i të Siguarit

Neni 46

Njoftimi në të shkruar lidhur me anulimin e sigurimit do t'i dërgohet të siguarit në adresën e fundit të shënuar të cilën fondi vullnetar pensional posedon në bazën e saj të shënimeve.

Bazuar në rregullat e BQK-së, fondi vullnetar pensional është e obliguar të informojë të gjithë të siguarit për gjendjen e llogarive të tyre personale gjatë tërë kohëzgjatjes së sigurimit, lidhur me detajet vijuese:

- Vlera e mjeteve në llogaritë e tyre personale dhe gjendja, siç është më 31/12 të vitit të fundit kalendarik, në formë të shkruar.

- Niveli i kontributeve të paguara në vitin e fundit kalendarik.

Fondi vullnetar pensional po ashtu do t'i informojë të siguarit për çdo ndryshim në pajtueshmëri me ligjin në fuqi.

Shërbimet të cilat do të kryhen nga fondi vullnetar pensional bazuar në kërkesat e të siguarit dhe të cilat nuk janë të parashikuara me këtë plan pensional, si p.sh. informimi për gjendjen e llogarisë personale jashtë afatit (termeve) të informimit të paraparë me këtë plan pensional; çdo kërkesë për kopje shtesë të dokumentacionit, etj, fondi vullnetar pensional mund të ngarkojë pagesë shtesë.

Llojet e tjera të informimit për llogaritë individuale nëpërmjet:

1. Projekti "Llogaria ime" në faqen e internetit (24 orë në ditë – nuk paguhet)

2. SMS porosi (ngarkohet nga operatori mobil)

Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve Sh.A.

Rr. Ukshin Hoti Nr.45/10
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

T: +381 38 22 00 31

F: +381 38 22 00 35

E: info@fskp.eu

www.fskp.eu